

# Europa *për* gratë



Këtë broshurë në gjuhën shqipe dhe angleze si dhe shpjegime të shkurtra dhe të qarta për BE-në mund t'i gjeni në internet në:

[ec.europa.eu/publications](http://ec.europa.eu/publications)

<http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>

<http://integrimi.gov.al/>

Komisioni Europian  
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikimin  
Publikimet  
1049 Bruksel  
BELGJIKË

Botimi në gjuhën shqipe u përgatit në kuadër të projektit të asistencës teknike SMEI 3 «Mbështetje për Procesin e Integritimit Europian – faza III», financiar nga Bashkimi Europian (IPA 2010).

Ilustrimet: [cecilebertrand@cartoonbase.com](mailto:cecilebertrand@cartoonbase.com)

Luxembourg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Europian

20 fq. — 12 × 18.5 cm

ISBN 978-92-79-14029-7

doi: 10.2775/43220

© Bashkimi Europian, 2009

Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive të veçanta duhet të kërkohet leja drejtpërdrejt nga ata që kanë të drejtën e autorit.

*Shtypur në Shqipëri*



# Europa për gratë


*Europa për gratë* pasqyron disa nga fushat e shumta ku veprimi mbarë European ka një ndikim të madh në çështjet që shqetësojnë të gjithë, veçanërisht gratë. Vendimet e BE-së sjellin një ndryshim të vërtetë në jetën dhe të ardhmen tuaj, që nga barazia gjinore në të drejtat e konsumatorit, nga ekuilibrimi i kërkesave profesionale dhe atyre të jetës personale në standartet e shëndetit më të mirë.



# Një angazhim i fuqishëm për barazinë gjinore

*Ligjet e BE-së janë kryesore për sigurimin  
e shanseve të barabarta për gratë*

Trajtimi i barabartë i grave dhe burrave ka qenë një parim themelor i BE-së më 1957, kur Traktati i Romës formuloi parimin e pagës së barabartë. Që nga vitet 1970-të, legjislacioni Europian dhe kombëtar kanë zgjeruar mundësitë e zgjedhjes për gratë dhe kanë përmirësuar jetën e tyre.



Pjesëmarrja e grave në punë është rritur vazhdimisht që nga viti 2000 dhe punonjëset gra kanë siguruar tre të katërtat e miliona vendeve të reja të punës në Europë. Vajzat tani mësojnë më mirë në shkollë sesa djemtë dhe zenë 59% të të diplomuarve universitarë në BE.

Megjithatë, gratë paguhen 16% më pak sesa burrat dhe përbëjnë një pakicë në vendimmarrjen politike dhe në pozitat e larta drejtuese.

Në këtë mënyrë BE-ja po rrit veprimtarinë për eliminimin e diskriminimit dhe arritjen e barazisë gjinore. Objektivat kryesore përfshijnë kundërshtimin e stereotipeve dhe arritjen e pavarësisë ekonomike të grave, që ato të mund të punojnë, të fitojnë të ardhurat e tyre dhe të kenë të drejta të barabarta në përfitime.

Programet e BE-së i përkrahin këto qëllime me mbështetje financiare. BE-ja ka krijuar gjithashtu një rrjet të grave në vendimmarrje për të patur mundësi të kenë pushtet dhe po krijon një Institut European për Barazinë Gjinore.




# Një e ardhme e blertë për planetin e blertë

*Europa po kryeson përpjekjen globale për të ndalur ndryshimin e klimës*

Çfarë bote do t'u lemë ne fëmijëve tanë? Kjo është një pyetje shqetësuese. Secili brez ka një përgjegjësi ta bëjë jetën pak më të mirë për brezin tjetër, por ndryshimi i shpejtë i klimës përbën një rrezik real që pasardhësit tanë do të duhet të përballojnë me rritjen e nivelit të deteve, pakësimin e ushqimit dhe të ujit, shtimin e sëmundjeve dhe turbullirat serioze sociale.

Por nuk është shumë vonë për ta ndalur këtë situatë. BE-ja u bë që herët e ndërjegjshme për rrezikun e ndryshimit të klimës. Ajo ishte pioniere në veprimin në nivel botëror dhe u kërkoi marrjen e masave konkrete për uljen e emisioneve të gazit me të paktën 20% deri më 2020.

Kërkimet Europiane ndihmojnë për gjetjen e rrugëve të reja për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga era, uji, dielli, karburantet me origjinë bio, dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Shumë mund të përfitohet nga iniciativat e vogla lokale dhe teknologji të reja të sukseshme mund të përdoren në gjithë Europën.





# Kur gruaja është shefe

*BE-ja përkrah gratë të hapin biznesin e tyre*



Në gjithë Europën janë më të shumtë burrat sesa gratë që kanë bizneset e tyre dhe drejtojnë kompanitë. Sipërmarrësit zënë 8% të fuqisë punëtore gra, në krahasim me 16% të burrave. Gratë zakonisht ndeshin vështirësi më të mëdha për financime dhe për hapjen dhe zgjerimin e bizneseve të tyre të vogla: të dhënat e fundit tregojnë se ka të ngjarë që burrat të jenë tre herë më shumë të vetëpunësuar me personelin e tyre.

BE-ja beson se gratë sipërmarrëse të talentuara mund ta rritin mirëqenien Europiane dhe që nga viti 1980 u ka dhënë mbështetje praktike grave që duan të hapin biznesin e tyre. Një iniciativë e filluar në vitin 2004 synon rritjen e bizneseve të hapura nga gratë.






Rrjeti European i BE-së për nxitjen e sipërmarrjes nga gratë përbëhet nga përfaqësues të qeverive, të cilët janë përgjegjës për nxitjen e sipërmarrjes nga gratë. Ai ka anëtarë në 31 vende Europiane, që japin këshilla, mbështetje dhe bëjnë kontakte me grate sipërmarrëse, duke i ndihmuar ato të rritin profilin e tyre dhe të zgjerojnë biznesin.

Nëpërmjet Fondit Social European, ato marrin trajnim dhe këshillim të specializuar. BE-ja ka hapur gjithashtu një portal për sipërmarrjen e grave, duke inkurajuar punën në rrjet të grave sipërmarrëse brenda dhe ndërmjet vendeve Europiane.

# BE-ja dhe lodrat

*Përparësi mbrojtjes së fëmijëve përmes rregullave për lojra të sigurta*

Të gjithë prindërit e dinë sa shpejt i kapin fëmijët lojrat e reja dhe marrëzitë. Vendosja e standardeve të larta për prodhimin dhe shitjen e lodrave është një nga rrugët që BE kujdeset për interesat e konsumatorëve dhe mbrojtjen e fëmijëve.



Rregullat e BE-së detyrojnë prodhuesit dhe shpërndarësit që mallrat që hidhen në treg të jenë të sigurta dhe kriteret për lodrat janë veçanërisht të rrepta. Autoritetet kombëtare shqyrtojnë gjëndjen që këto kërkesa të plotësohen. Nëse gjendet ndonjë shkelje në një vend, sistemi i shpejtë i alarmit siguron që produkti përkatës të tërhiqet nga dyqanet në gjithë BE-në.

Shqetësimi për disa importe nga jashtë ka bërë që BE-ja të forcojë qëndrimin e saj. Lodrat që kanë magnet tani duhet të kenë, p.sh. paralajmërimin e duhur për rreziqet që paraqesin. Rreziqet potenciale duhet të identifikohen që herët. Në mënyrë të veçantë BE-ja merr masa për të siguruar që prodhuesit dhe eksportuesit — si Shtetet e Bashkuara dhe Kina — të adoptojnë standarde të larta sigurie. Mirëqenia e fëmijëve duhet të jetë një përparësi në të gjithë linjën e furnizimeve.



# Një front i bashkuar në kohë të vështira

*BE-ja lufton krizën ekonomike me veprim kombëtar të koordinuar*

Rënia ekonomike bëri që Europeanët të shqetësohen për jetesën e tyre. Njerëzit në gjithë Europën u prekën nga kjo rënie dhe sidomos gratë.

Tani e dimë që teprimet ekonomike dhe financiare në botë janë përgjegjëse që shkaktuan krizën më të madhe ekonomike të kohës sonë, me ndërlikime të rënda për punësimin dhe të ardhurat. BE-ja reagoi shpejt duke i bashkuar qeveritë në përpjekjet e tyre për të luftuar krizën dhe shpenzuan miliarda euro në ekonomi për të rritur kërkesën dhe për të rikthyer besimin. U deshën përpjekje për të garantuar stabilitetin e sistemit financiar, ndërsa euro ndihmoi vendet e vogla në luftën kundër gërryerjes ekonomike.

Bashkimi ndihmon edhe qytetarë të veçantë për të përballuar ndikimin e rënies ekonomike. Fondi Social European ndihmon 10 milion njerëz çdo vit, më shumë se gjysma e tyre gra për të fituar aftësi të reja, për të gjetur punë, për të luftuar pabarazitë në vendin e punës.

BE-ja duhet të shkojë më tej me hapa praktike për të forcuar solidaritetin social dhe stabilitetin, duke përmirësuar arsimin, duke i hapur rrugën lulëzimit të aftësive njerëzore. Kriza i dha mundësi të nxjerrë mësim të rëndësishme dhe të vendosë si duhet të ndërtojë tablonë ekonomike në të ardhmen; si duhet të mbështesë më mirë bizneset Europiane që ato të lulëzojnë, duke patur në vëmendje çështjet sociale.

# Mbrojtja e grave nga dhuna

*BE-ja lufton kundër trafikimit, abuzimit dhe dhunës ndaj grave*

Dhuna ndaj grave është e papranueshme në çfarëdo lloj forme. Megjithatë, në Europë shumë gra dhe vajza vazhdojnë të jetojnë nën hijen e agresionit dhe shfrytëzimit. Ato mund të jenë viktimat e dhunës në familje ose të abuzimit seksual, të trafikimit dhe prostitucionit të imponuar, apo të frikësimit dhe zgjedhës — duke shkelur të drejtat e tyre themelore të lirisë, dinjitetit dhe sigurisë.

BE-ja lufton trafikimin dhe shkaqet e tij, ndjek bandat kriminale që rrëmbejnë gratë, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar midis policisë dhe gjykatave dhe shkëmbimit të perfeksionuar të të dhënave të fshehta. Kjo funksionon me autoritetet në zona si Ballkani, për të luftuar krimin e organizuar. Zbutja e varfërisë në vendet në zhvillim i bën edhe gratë më pak të prekshme nga shfrytëzimi.

Komisioni Europian ka një program që quhet “Daphne” dhe që mbron gratë, fëmijët dhe të rinjtë nga të gjitha format e dhunës. Ai financon projekte si strehëzat e grave dhe lehtësi për shëndetin, si edhe përpjekjet për të ndryshuar qëndrimin dhe për të mbrojtur gratë e grupeve migrante dhe të pakicave etnike.

# Shkathësia për të ndërtuar me sukses jetën profesionale dhe atë personale

*BE-ja ndihmon njerëzit për të balancuar kërkesat e punës me ato të shtëpisë*


Kombinimi i punës me kujdesin për fëmijët dhe për pjestarë të tjerë të familjes është çështje kryesore për gratë dhe



sa vjen e më shumë edhe për burrat. Por ndarja e përgjegjësive në shtëpi është ende e pabarabartë, gjë që e bën më të vështirë për gratë të ndjekin karrierën. Vetëm 67% e grave me fëmijë të vegjël në BE janë në punë, në krahasim me 92% të burrave.

BE-ja përkrah një ekuilibër më të mirë midis jetës profesionale, asaj private dhe familjare, kështu që gjithëkush mund të planifikojë të ketë fëmijë apo të kujdeset për të afërm të tjerë, pa u stresuar apo pa u varfëruar. Ka ligje që mbrojnë punonjësit me kohë të pjesëshme, të vetëpunësuarit, bashkëshortet që ndihmojnë si dhe standarde minimale për lejen e barrëindjes dhe lejen prindërore.

Shtetet anëtarë të BE-së kanë përcaktuar objektiva për të dhënë shërbime të cilësisë së lartë të kujdesit për fëmijët në të gjithë Europën. Në krizën e sotme ekonomike, politikat e fuqishme në mbrojtje të interesave të grave që nuk janë vënë në jetë, kanë një rëndësi të veçantë.



# Kontrolli i kimikateve të rrezikshme

*Rregullat e reja të sigurisë zbatohen për rreth 30 000 lëndë potencialisht të rrezikshme që përdoren në Europë*


Në botën e sotme, kimikatet na rrethojnë në çdo hap: ato janë jetike në prodhimin e çdo gjëje, që nga veshjet deri te aparatet televizive. BE-ja ka ndërmarrë hapa vendimtarë për të mbrojtur njerëzit nga rreziqet e këtyre lëndëve, duke ndjekur konsultime të gjera publike.

Legjislacioni ambicioz që ka të bëjë me regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin (REACH) e lëndëve kimike hyri në fuqi më 2007 dhe do të çojë në heqjen e lëndëve të rrezikshme. Ai hap një rrugë krejt të re duke i lënë përgjegjësinë industrisë për të mbledhur të dhëna dhe për të garantuar sigurinë e lëndëve kimike.

Kimikatet dioxins — noxious që vijnë nga disa procese industriale dhe shtëpiake — kanë shkaktuar një frikë të madhe vitet e fundit. Madje edhe koncentrimet të vogla mund të dëmtojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut, sisemin imunitar, sistemin nervor dhe hormonal dhe funksionin riprodhues. BE-ja ka ndërmarrë një strategji të luftës kundër këtij rreziku dhe po punon në nivel global për të penguar çlirimin e këtyre lëndëve toksike rezistente për një kohë të gjatë.

Europa ka luajtur gjithashtu një rol kryesor në inkurajimin e industrisë për të prodhuar lloje plastike që dekompozohen më lehtë nga agentë biologjikë dhe që përdoren për qese, gota, amballazh ushqimor, vazo lulesh dhe qindra artikuj me bazë polimeri, që konsumatori i konsideron normale.





# Ta mbash doktorin larg


*Qeveritë e BE-së, mjekët dhe ekspertët punojnë së bashku për të përmirësuar standardet e shëndetit në Europë*

Shëndeti është një fushë ku vendet e BE-së mund të punojnë bashkërisht për të gjetur zgjidhjet për problemet e përbashkëta. Gratë në Europë kanë risqe të veçanta për shëndetin.

Kanceri është shkaku i dytë më i zakonshëm për vdekjet në BE dhe kanceri i gjirit, ai cervikal dhe kolonorektal zënë 32% të vdekjes nga kanceri tek gratë. Bashkimi inkurajon shtetet anëtare të ndërtojnë programe ekzaminimi të cilësisë së lartë në shkallë të gjerë për të dhënë diagnosë të hershme dhe për të përmirësuar normën e mbijetesës në BE. Bëhen rreth 51 milion ekzaminime në vit, po duhet të bëhet dyfishi për të mbuluar të gjitha grupet në rrezik.

Mbipesha është një problem serioz në Europë për të rriturit dhe për fëmijët. Numri i fëmijëve që janë mbipeshë në Europë po shkon në 400.000 vetë në vit. BE-ja ka ndërmarrë një iniciativë për të nxitur një mënyrë jetese të shëndetshme, që nga mosha e re, për shembull, nëpërmjet programeve që shpërndajnë qumësht, fruta të freskëta dhe zarzavate për fëmijët e shkollës.






# Të marrësh shumë seriozisht interesat e konsumatorit

*Masat e BE-së për sigurinë e ushqimit ndihmojnë Europeanët të zgjedhin duke pasur informacion*

Frika për ushqimin, nëse ka dioksinë tek mishi i derrit apo pesticide tek frutat, i shqetëson Europeanët dhe mund të krijojë rreziqe serioze, sidomos në fëmijët dhe të moshuarit.

BE-ja merr një numër të madh masash për të siguruar që ushqimi të konsumohet pa frikë në gjithë Europën si dhe për të nxitur një dietë të shëndetshme. Ato mbulojnë gjithë rrjetin e furnizimit të ushqimeve, duke vendosur standarde dhe duke monitoruar gjendjen dhe mirëqenien e kafshëve, bimët dhe prodhimet, si dhe ushqimet e importuara.

Europa vendos rregulla të rrepta për prodhimet organike dhe nuk i lejon prodhuesit e mallrave ushqimore ose të mallrave për t'u dobësuar, që të bëjnë premtime të pasakta ose joreale. Legjislacioni i BE-së mbi etiketimin e ushqimeve ndihmon konsumatorët të jenë të informuar kur bëjnë blerje.



# Pika kontakti me BE-në



## ■ ONLINE



Informacione në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian gjenden në faqen e internetit Europa: [europa.eu](http://europa.eu)

## ■ PERSONALISHT



Në mbarë Europën ka qindra qendra lokale informative të BE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në faqen e internetit Europe Direct: [europedirect.europa.eu](http://europedirect.europa.eu)

## ■ PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS



**Europe Direct** është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja mbi Bashkimin Europian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6/7/8/9/10/11**, (disa operatorë të telefonave celular nuk lejojnë hyrjen në numrat 00800 ose janë me pagesë), telefonin me pagesë nëse merrni nga vendet jashtë BE-së **+32 2 2999696** ose me anë të postës elektronike të faqes së internetit Europe Direct: [europedirect.europa.eu](http://europedirect.europa.eu)

## ■ LEXONI MBI EUROPËN



Për të lexuar botimet mbi BE-në, duhet të klikoni vetëm një herë në faqen e internetit të librisë së BE-së: [bookshop.europa.eu](http://bookshop.europa.eu)

## ■ NË SHQIPËRI

Ju mund të gjeni informacion dhe broshura mbi Bashkimin Europian në:



### **Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri**

ABA Business Center,  
Rr. Papa Gjon Pali II, kati 17  
Tiranë, Shqipëri  
Faqja e Internetit : [www.eeas.europa.eu/delegations/albania](http://www.eeas.europa.eu/delegations/albania)  
Telefon: +355 (0)4 222 8320 ose 223 0871 – 222 8479 – 223 4284  
Fax: +355 (0)4 223 0752  
E-mail: [delegation-albania@eeas.europa.eu](mailto:delegation-albania@eeas.europa.eu)

### **ndiq Delegacionin e BE në:**

Portal: [www.eudalbania.eu](http://www.eudalbania.eu)  
Facebook: [www.facebook.com/eu.delegation.albania](http://www.facebook.com/eu.delegation.albania)  
Twitter: [www.twitter.com/eu\\_albania](http://www.twitter.com/eu_albania)

**Qendra e Informimit të BE-së në Tiranë**

Rr. "Ismail Qemali", Nr. 32  
Tiranë, Shqipëri  
Faqja e Internetit: [www.euinfocentre.al](http://www.euinfocentre.al)  
E-mail: [info@euinfocentre.al](mailto:info@euinfocentre.al)  
Telefon & Fax: +355 (0)4 226 1767

**Qendra e Informimit të BE-së në Shkodër**

Rr. "Kolë Idromeno" (Pedonale), Nr. 63  
Shkodër, Shqipëri  
Faqja e Internetit: [www.shkodra.euic.al](http://www.shkodra.euic.al)  
Telefon & Fax: + 355 (0)22 254 552

**Qendra e Informimit të BE-së në Vlorë**

Bulevardi "Ismail Qemali"  
Vlorë, Shqipëri  
Faqja e Internetit: [www.vlora.euic.al](http://www.vlora.euic.al)  
Telefon & Fax: +355 (0)33 408 688

**Ministria e Integritimit Europian**

Ministria e Integritimit  
Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3  
Kutia Postare Nr. 8302  
Tiranë, Shqipëri  
Faqja e Internetit: <http://integrimi.gov.al>  
Telefon: +355 (0)4 222 8623, 08000809  
Fax: +355 (0)4 222 8623  
E-mail: [info@integrimi.gov.al](mailto:info@integrimi.gov.al)

**Projekti i Mbështetjes së Proçesit të Integritimit në BE (SMEI 3)**

Ministria e Integritimit  
Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon: +355 (0)4 223 6790 / 6741  
Faqja e Internetit: <http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>  
E-mail: [info@smei3.com](mailto:info@smei3.com)

Komisioni Europian dhe Parlamenti Europian ka Përfaqësi dhe zyra në të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Bashkimi Europian gjithashtu ka delegacione në pjesët e tjera të botës.

# Europa për gratë

*Europa për gratë* pasqyron disa nga fushat e shumta ku veprimi mbarë Europian ka një ndikim të madh në çështjet që preokupojnë të gjithë, veçanërisht gratë. Vendimet e BE-së sjellin një ndryshim të vërtetë në jetën dhe të ardhmen tuaj, që nga barazia gjinore në të drejtat e konsumatorit, nga ekuilibrimi i kërkesave profesionale dhe atyre të jetës personale në standardet e shëndetit më të mirë.



Zyra e Publikimeve

ISBN 978-92-79-14029-7

